



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V_958_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1580_05_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **11.07.2017**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin R.R, nga Komuna e Prishtinës, me shifër të konsumatorit **DPR - 90014408** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1580_05_17 i datës 22.05.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 11.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se faturimi i konsumatorit ne periudhën nëntor 2014 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi si dhe me shpenzimet reale mujore te konsumatorit dhe se konsumatorit i janë dërguar dy fatura, ku njëra i ka shkuar deri më datën 14.11.2014 ne vlere financiare 105.44€, ndërsa tjetra faturë i është llogaritur nga data 14.11.2014 deri në fund të muajit me shpenzim ne vlere financiare prej 325.03€ ne mënyrë te vlerësuar. KESCO gjithashtu thekson se ZRRE vendimin e saj e mbështet në rrjedhën e energjisë elektrike dhe se edhe nëse do te anulohet shpenzimi i ngarkuar ne faturën e dytë per periudhën nëntor 2014 e qe është e qartë se ky shpenzim është krijuar deri me datë 30.03.2015 dhe se faturimi i tyre prapë do te ishte i njëjtë per shkak te mos ndryshimit te tarifave.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE _V_1580_05_17, në lidhje me shifrën **DPR - 90014408** si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se faturimi i konsumatorit do të mbetet i njëjtë edhe përkundër faktit që konsumatori është faturuar pa matje /vlerësuar dhe se shpenzimi i energjisë elektrike nuk ka mundur të përcaktohet deri në periudhën 03/2015, për Bordin pretendimet të tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme.

Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe konstaton se për periudhat 12/2014, 01/2015, 02/2015 nuk ka faturim me shpenzim real mujor, por që konsumatori është faturuar vetëm me taksa. Nga rrjedha e energjisë elektrike aktive vërehet se nga muaji 03/2015 deri me 04/2017 ka filluar leximin me matje.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore mund të konstatojmë se në rastin konkret konsumatori ka pasur obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë dhe atë pa matje/paushall, e duke mos e arsyetuar faturimin e tillë. Andaj edhe është kërkuar të shkarkohet konsumatori me shifër DPR – 90014408 nga fatura e energjisë elektrike nr. 11140DPR-90014408 e datës 01.12.2014 në vlerë prej 325.09€.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit R.R dhe,
- Arkivit të ZRRE-së